



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. **32/2020**
Datë: **6 MAJ 2020**

Mbështetur në nenin 3, paragrafi 1 me nën par. 1.2, dhe 1.8, nenin 4, paragrafi (1) me nën paragrafin 1.1 nenin 28, paragrafi (1) me nën paragrafët 1.3, 1.4 dhe 1.5; nenet 35, 36, 37, 38, 45, 47, 49, 54, paragrafi (1) me nën paragrafin 1.8, neni 56 paragrafi (1) me nën paragrafin 1.1, neni 59, 60, 63 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën e përcaktimit të tregut relevant Nr. 02/2018; Udhëzimit Administrativ Nr.01/2018 Mbi Kriteret për Shqiptimin e Masës së Sanksioneve Administrative; Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në përbërje të: Valon Prestreshit – Kryetar, Ahmet Krasniqit – zv. Kryetar, Fatime Hazirit – Komisionere, Muhamed Krasniqit – Komisioner, Shaqir Morinës – Komisioner në mbledhjen e mbajtur me datën **6 MAJ 2020** merr këtë:

V E N D I M

- I. KONSTATOHET se ndërmarrja AL- PETROL Shpk me Nr. Fiskal: [REDAKTUAR] ka ç'rregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve NËNTOR e DHJETOR të vitit 2018, e që me këto veprime ka kryer shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, nenin 4 "Marrëveshje të ndaluar apo praktikë e bashkërenduar", paragrafi 1 nën paragrafi (1.1).
- II. Ndërmarrjes AL- PETROL Shpk i shqiptohet masa ndëshkuese administrative në shumën prej ([REDAKTUAR]%) të totalit të të hyrave për gjashtë (6) mujorin e vitit 2018, në vlerë prej 989,493.12 €, me shkronja (*Nëntëqind e tetëdhjet e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre pikë dymbëdhjetë/Euro*). Mjetet nga masa ndëshkuese administrative të transferohen në llogarinë bankare të buxhetit të Republikës së Kosovës sipas afatit ligjor pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- III. KONSTATOHET se ndërmarrja AL- PETROL Shpk nuk ka abuzuar me pozitën dominuese në treg individuale apo kolektive përkatësisht nuk ka shkelje ligjore sipas nenit 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- IV. URDHËROHET ndërmarrja AL- PETROL Shpk të ndaloj çdo veprim të mëtutjeshëm sikur në pikën I të këtij vendimi që ka të bëjë me vendosjen e çmimeve në mënyrë të bashkërenduar/heshtur me ndërmarrje tjera në dëm të konsumatorëve dhe çdo veprim tjetër që ç'rregullon konkurrencën në tregun përkatës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni.

ARSYETIM

I. FILLIMI I PROCEDURËS EX-OFFICIO

1. Bazuar në shqetësimet e ngritura nga opinioni publik, përmes mediave dhe shoqërisë civile rreth pretendimeve të tyre për marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar në mes të ndërmarrjeve të cilat merren me tregtimin me derivate të naftës në shitjen me shumicë dhe pakicë të naftës dhe benzinës në territorin e Republikës së Kosovës, Komisioni i AKK-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.12.2018, ka vendosur për monitorimin e tregut në sektorin e naftës.
2. Pretendimet e opinionit publik, të mediave dhe shoqërisë civile janë se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e derivateve të naftës, kanë arritur marrëveshje të fshehët për t'i fiksuar apo kurditur çmimet.
3. Gjithshtu opinioni i gjithëmbarshtëm dhe mediat në përgjithësi kanë pretenduar se përkunder faktit se ka pas rënie në bersën botërore të naftës, ndërmarrjet që operojnë në Republikën e Kosovës në këtë treg nuk kane reflektuar karshi cmimit të bersës botërore.

II. PROCEDURA E NDJEKUR NGA AUTORITETI

1. Komisioni i Autoritetit Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare pas shqyrtimit të raportit paraprak nr. 33/19-08/B i datës 11.02.2019 në tregun e derivateve të naftës për shkak të dyshimit të bazuar për ç'rregullim të konkurrencës në tregun e derivateve të naftës në kundërshtim me nenin 4 "Marrëveshjeve të ndaluara" dhe nenin 11 "Abuzim me pozitën dominuese", në tregun relevante me datën 15.02.2019 ka marrë konkluzion për fillimin e procedurës hetimore ndaj 16 ndërmarrjeve të derivateve të naftës të cekuar në dispozitivin e konkluzionit nr.01/19.
2. Gjatë monitorimit në tregun përkatës në sektorin e naftës lidhur me rastin, takimeve të zhvilluara me palët të cilët merren me importin, blerjen dhe shitjen e derivateve të naftës me shumicë dhe pakicë, analizimit dhe vlerësimit të të dhënave të grumbulluara gjatë monitorimit, dokumentacioni i siguruar nga Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, MTI, MF, si dhe konsultimit me rregullativën ligjore që i rregullon këto çështje Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka nxjerrë strukturën e tregut të ndërmarrjeve të cilat importojnë dhe tregtojnë derivate të naftës me shumicë dhe pakicë, për ndërmarrjet të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në sektorin e tregut të naftës.
3. Përkritazi me këtë, Komisioni i AKK-së ka vendosur të fillojë procedurën e thelluar hetimore në tregun përkatës për të vërtetuar pretendimin mbi dyshimet nëse ka marrëveshje, koordinim, praktikë të bashkërenduar apo sjellje paralele në treg për fiksimin e çmimeve të naftës dhe benzinës ndërmjet ndërmarrjeve që janë objekt hetimi për këtë rast.
4. Autoritetit në mbështetje të nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndërmarrjes AL- PETROL Shpk me datën 22.11.2019 i ka dorezu Njoftimin e Fakteve paraprake të konstatuara në procedurë.

5. Autoriteti me datën 20.12.2019 ka pranuar komentet e ndërmarrjes AL- PETROL Shpk kundrejt Njoftimit të fakteve paraprake të konstatuara në procedurë.
6. Autoritetit, në përputhje me nenin 49 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226 për Mbrotjtjen e Konkurrencës, me datën 31.01.2020i ka paraqitur Konstatimin e gjendjes faktike.
7. Autoriteti me datën 14.02.2020 ora 10:00 ka zhvilluar Seancen Degjimore me ndermarrjen AL- PETROL Shpk.

III. PALËT NË PROCEDURË

1. Duke i'u referuar Konkluzionit nr.01/19 të Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, të datës 15.02.2019 palë në procedurë janë:

1. HIB PETROL Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
2. AL - PETROL Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
3. EX FIS Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
4. LAB - OIL Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
5. IP - KOS Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
6. PETROL COMPANY Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
7. ALBA PETROL GROUP Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
8. ALFA TRADE Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
9. KASTRATI - GROUP Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
10. PATRONI Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
11. BENITA COMPANY Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
12. N.P.T IBRAHIMI Nr. Fiskal: [REDACTED]
13. BLU OIL Shpk Nr. regjistrimit: [REDACTED]
14. PETROL OTI SLOVENIJA L.L.C Nr. Fiskal: [REDACTED]
15. VEDA -2 PETROLL Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]
16. N.P.T. FAT OIL Shpk Nr. Fiskal: [REDACTED]

IV. PËRCAKTIMI I TREGUT RELEVANT

1. Duke u bazuar në nenet 3, 4, 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës nr. 02/2018, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës përcakton se:
 - TREGU I PRODUKTIT – Tregu i produktit do të konsiderohet Natfa dhe Benzina.
 - TREGU GJEOGRAFIK konsiderohet të jetë territori i Republikës së Kosovës

V. PRETENDIMET E AUTORITETIT DHE KOMENTENT E PALËS

Pretendimet e AKK-së

1. Autoriteti në procesin e monitorimit në sektorin e naftës në Republikën e Kosovës ka vërejtur se ka mos reflektim të uljes së çmimit të naftës dhe derivateve të naftës kur ka lëvizje të çmimit, ulje apo ngritje, të këtij produkti në berëza. Andaj për ta vërtetuar dhe hollësisht analizuar këtë mos reflektim të uljes së çmimit Autoriteti ka ngritë procedurë hetimore duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.
2. Bazuar në Konkluzionin nr.01/19 i datës 15.02.2019 për fillimin e procedurës, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka pasur dyshime të bazuara për ç'rregullim të konkurrencës në tregun e derivateve të naftës në kundërshtim me nenin 4 "Marrëveshje të ndaluar" dhe nenin 11 "Abuzim me pozitën dominuese"
3. Komisioni i AKK-së ka caktuar periudhën e hetimit për ndërmarrjet nën hetim nga 01.01.2018 deri më 31.12.2018.
4. Për t'i vërtetuar pretendimet e veta, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka kërkuar nga Dogana të gjitha dudat doganor të importit të produktit Naftë dhe Benzinë nga ndërmarrja AL- PETROL Shpk.
5. Kodi tarifor për Produktin Naftë është 2710194300 ndërsa për produktin Benzinë është 2710124500.

Andaj

6. Për ta kalkuluar në mënyrë të saktë sasin e litrave të importuara nga kompania AL- PETROL Shpk Autoriteti, ka larguar nga formula e kalkulimit të gjitha ato importe të cilat nuk i'u kanë nënshtruar akcizës. Me konkretisht, ndërmarrja AL- PETROL Shpk ka importuar [REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
7. Dhe që, ndërmarrja AL PETROL gjatë vitit 2018 ka importuar [REDACTED] litra naftë dhe [REDACTED] litra benzinë dhe që në total [REDACTED] litra derivate për vitin 2018.
8. Ndërmarrja AL – PETROL ShPK ka këtë strukturë të tregut:
 - Pjesëmarrja e përgjithshme në treg për Naftë dhe Benzinë është 14.11%
 - Pjesëmarrja e përgjithshme në treg vetëm për NAFTË është 11.71%
 - Pjesëmarrja e përgjithshme në treg vetëm për BENZINË është 31.77%
9. Autoriteti duke u bazuar në të dhënat e ofruara nga Dogana e Kosovës, strukturën e tregut e ka kalkuluar në këtë formë: Shuma e përgjithshme e litrave¹ (l) të importuara nga ndërmarrja e juaj ishte [REDACTED] ndërsa shuma e përgjithshme e NAFTËS dhe BENZINËS në Republikën e Kosovës ishte [REDACTED] ([REDACTED] = 14.11%)

¹ Litra është njësi themelore në sistemin ndërkombëtar të njësive SI që përdoret për matjen e vëllimit të substancave të lëngëta. Vëllimin prej një litri e ka sasia e lëngut e cila mund të futet në një enë në formë të kubit me dimensione të tehut prej 1 dm, 1l = 1dm³

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Litri>

a. *Struktura e tregut për produktin NAFTË është kalkuluar si në vijim:*

- i. Shuma e përgjithshme e litrave të importuar vetëm për NAFTË nga ndërmarrja juaj ishte [REDACTED] ndërsa shuma e përgjithshme e të gjitha ndërmarrjeve të cilat kanë importuar Naftë në Republikën e Kosovës ishte [REDACTED] andaj ([REDACTED] = 11.71%).

b. *Struktura e tregut për produktin BENZINË është kalkuluar si në vijim:*

- i. Shuma e përgjithshme e litrave të importuar vetëm për BENZINË nga ndërmarrja juaj ishte [REDACTED] ndërsa shuma e përgjithshme e të gjitha ndërmarrjeve të cilat kanë importuar Benzinë në Republikën e Kosovës ishte [REDACTED] andaj, [REDACTED] = 31.77%).

10. Autoriteti duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 38 “mbledhja e të dhënave”, ka kërkuar nga ndërmarrja AL-PETROL, të gjitha shitjet me pakicë dhe shumicë për produktin naftë dhe benzinë për çdo ditë për tërë vitin 2018. Autoriteti e ka kalkuluar mesataren mujore të çmimit të naftës dhe benzinës për vitin 2018.

11. Po ashtu, Autoriteti duke u bazuar në të dhënat e doganës për secilin import që e ka bërë ndërmarrja AL-PETROL për gjatë vitit 2018, e ka kalkuluar mesatarën e çmimit blerës të naftës dhe benzinës për çdo muaj.

12. Çmimin blerës të ndërmarrjes AL – PETROL, Autoriteti e ka kalkuluar në këtë formë:

Cmimi blerës me taksa (i+f)/a --- shih tabelën më poshtë.

a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	
Sasia	Vlera	Shpenz.e Transportit	Shpenz. e sigurimeve	Shp. Tjera	Vlera doganore	Taksa akciza	Taksa tvsh	Totali	I	Cmimi/l	Cmimi
								taksave	nga	bersa	me
								=(d+e+g+h)	=(f/a)	=(i+f)/a	

13. Autoriteti fitimin bruto e ka kalkuluar duke zbritur Çmimin blerës nga Çmimi shitës, dhe si rezultat Autoriteti me programin “excel” ka gjeneruar tabelën e mëposhtme:

	AL-PETROL - NAFTË											
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NTENTOR	DHJETOR
C/BLERES	€ 0.95	€ 0.93	€ 0.93	€ 0.97	€ 1.01	€ 1.02	€ 1.01	€ 1.02	€ 1.04	€ 1.09	€ 1.02	€ 0.93
C/SHITES	€ 1.04	€ 1.04	€ 1.02	€ 1.03	€ 1.07	€ 1.14	€ 1.14	€ 1.16	€ 1.16	€ 1.18	€ 1.18	€ 1.14
FITIMI BRUTO	€ 0.09	€ 0.11	€ 0.09	€ 0.06	€ 0.06	€ 0.12	€ 0.13	€ 0.14	€ 0.12	€ 0.09	€ 0.16	€ 0.22

14. Kjo formulë është aplikuar njëjtë për produktin Naftë dhe Benzinë.

VI. NJOFTIMI I FAKTEVE PARAPRAKE TË KONSTATUARA NË PROCEDURË

1. Autoritetit në mbështetje të nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndërmarrjes AL - PETROL me datën 22.11.2019 i ka dorëzuar Njoftimin e Fakteve paraprake të konstatuara në procedurë.

VII. KOMENTET E PALËS KUNDREJT NJOFTIMIT TË FAKTEVE PARAPRAKE TË KONSTATUARA NË PROCEDURË

1. Autoritetit në afatin ligjor, me datën 20.12.2019 i ka pranuar komentet e palës në procedurë kundrejt Njoftimit të fakteve paraprake të konstatuara në procedurë.

VIII. NJOFTIMI PËR KONSTATIMIN E GJENDJES FAKTIKE

1. Autoriteti me datë 31.01.2020 në bazë të autorizimeve sipas nenit 49 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimin nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës, nenit 95 të Ligjit nr. 05/l -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndermarrjes AL - PETROL i ka paraqitur Njoftimin për Konstatimin e Gjendjes Faktike në rastin e derivateve të naftës.

8. SEANCA DËGJIMORE

1. Autoriteti duke u bazuar në nenin 47 i Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimin nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës, ka organizuar seancë dëgjimore lidhur me rastin e derivateve të naftës, me qëllim që Ndërmarrja AL – PETROL të ketë mundësin për të paraqitur informacionet apo provat e reja bazuar në faktet që i kanë pranuar lidhur me konstatimin e shkeljeve ligjore.
2. Autoriteti ju ka derguar ftesë për pjesëmarrje në seancë degjimore me datën 31.01.2020 për t'u paraqitur në seancë me 14.02.2020 në ora 10:00.
3. Pjesëmarrës në seancë nga ana e ndërmarrjes AL-PETROL ishin: Z. Latif Kryeziu – Pronar Z. Tahir Zogaj – Drejtor Financiar, zonja Elmaze Fazliu - Pëfaqësuese Ligjore .
4. Pjesëmarrës në seancë nga ana e Autoritetit ishin: Z. Valon Prestreshi – Kryetar, Z. Ahmet Krasniqi – Zëvendëskryetar, Znj. Fatime Haziri - Anëtare e Komisionit, Z. Muhamed Krasniqi - Anëtar i Komisionit, Z. Shaqir Morina - Anëtar i Komisionit, Z. Sakip Imeri - Drejtori i Përgjithshëm, Z. Bekim Millaku - Drejtor i DMT-së, Z. Selajdin Beqa - Udhëheqës, DMN, Z. Rizah Arifi - Udhëheqës, DPD, Z. Etrit Tetova- Udhëheqës, AMDE, Procesmbajtës Znj. Besa Beqiri - Inspektore hetues DMN.
5. Seanca dëgjimore u zhvillua duke u mbështetur në UDHEZUESIN PËR ORGANIZIMIN E SEANCAVE DËGJIMORE, dokument i brendshëm i Autoritetit. Seanca u kryesua nga Kryetari i Komisionit të AKK-se z. Valon PRESTRESHI.
6. Në ora 10:00 e datës 14.02.2020 Kryetari Prestreshi hapi zyrtarisht seancën degjimore. *Valon Prestreshi - Mirëdita për përfaqësuesit e Al Petrol, përshëndetje edhe për përfaqësuesen e Odës Ekonomike Amerikane. Të nderuar të pranishëm, sot me datën 14.02.2020 në ora 10:00 po e hapi seancën dëgjimore për rastin Nafta. Kjo seancë dëgjimore do të regjistrohet me audio inqizim dhe me procesverbal. Ju njoftoj se ndalohet ndërprerja e fjalës së folësit, ndalohet çdo inqizim tjetër i pa-autorizuar në këtë sallë, ndalohet përdorimi i celularëve, ndalohet prishja e qetësisë dhe pirja e duhanit. Para se të procesojmë tutje pyes palën në procedurë se a ka ndonje vërejtje me përmbajtjen e pjesëmarrësve në seancë, kjo pyetje rrjedh për të evituar ndonjë konfikt të mundshëm interesi. Avokati i Al Petrol - Nuk kemi vërejtje. Valon Prestreshi - Gjithashtu para se të vazhdojmë tutje me seancën dëgjimore jamë i detyruar që të pyes palen se a e ka kuptuar për qfar po fajsohet kompania e tijë apo kompania që e përfaqëson. Avokati i AL Petrol - Po e kemi kuptuar. Valon Prestreshi - Po ashtu e njoftojë komisionin dhe sekretariatin se në seancë e kemi edhe një përfaqësues nga Oda Ekonomike Amerikane, me kërkesë të palës.*
7. Pas kësaj Kryetari Prestreshi u'a lexoje palëve arsyen pse janë të thirrur në këtë seancë dhe se për t'i sqaruar të gjitha pretendimet e hetueseve të AKK-së si dhe për ta ndëgjuar

mbrojtjen e palës në procedurë, Komisioni i AKK-së dëshiron që në këtë seancë dëgjimore t'i ndëgjoj thënjet dhe kundërthënjet e Palës në procedurë dhe hetueseve të Autoritetit.

8. Kryetari Prestreshi kaloi fjalën te Sekretariati i AKK-se, të cilët shpalosen faktet dhe dëshmitë e nxjerrura nga hetimet e bëra dhe lexuan "Njoftimin e fakteve paraprake të konstatuara në procedurë" dhe "Konstatimin e gjendjes faktike".
9. Gjatë fjalës së Sekretariatit të AKK-se ata u tërhoqen nga pretendimet e tyre për shkelje të nenin 11 Abuzim me pozitën dominuese të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Citoj: "Gjatë vlerësimit dhe analizimit të të dhënave, sa i përket veprimeve të kompanisë në treg në kuptim të nenit 11 abuzim me pozitën dominuese – sekretariati i AKK nuk ka arritur të dëshmojë se kompania Al Petrol ka abuzuar me fuqinë e saj kompania ose kompanitë në bashkëveprim- si dominancë kolektive në treg, përkatësisht nuk i plotëson kushtet ligjore për vazhdim të mëtutjeshëm të hetimit sipas nenit 11 të LMK për abuzim me pozitën dominuese në treg.
10. Detajet tjera i gjeni në proces verbal.

9. TË GJETURAT DHE ANALIZA E KONKURRENCËS

1. Për të konstatuar Marrëveshjen e ndaluar apo praktiken e bashkërenduar, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës është bazuar në nenin 3 par.1.2 si dhe neni 4 par.1 pika 1.1 dhe nenin 66 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës citoi: "Zbatimi i këtij Ligji duhet të jetë në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian për Konkurrencën".
2. Duke u bazuar në plotësim ndryshim e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës – Marrëveshje është: çdo formë, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikën e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, ose në nivele të ndryshme, të tregut.
3. Duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, *Praktika e bashkërenduar* është një aktivitet që ka të bëjë me bashkëpunimin joformal në mes të dy ose më shumë ndërmarrjeve dhe që nuk bazohet në një vendim ose marrëveshje formale.
4. Komisioni i Autoritetit Kosovar i Konkurrencës, në mbështje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 66 si dhe në mbështetje të punimit "*Ekonomia në Marrëveshjet e heshtura*"²(*The Economics of Tacit Collusion*) e përgatitur për DG Competition jep këtë sqarim dhe përcaktim për *Marrëveshjet e heshtura*:

a. Marrëveshjet e heshtura -


- i. Koluzioni i heshtur, nuk do të thotë detyrimisht involvimi në ndonjë marrëveshje të heshtur apo involvimi i palëve për t'u marrur vesh apo komunikuar. Por ju referohet marrëveshjes së heshtur sepse rezultati (në terma të caktimit të cmimit apo të sasisë së prodhuar) mund të ngjasojë me MARREVESHJE EKSPICITE apo edhe të një KARTELI ZYRTAR.
- ii. Koluzioni apo marrëveshje e heshtur është një sjellje e tregut që u mundëson firmave të fitojnë fitime ekstra-normale, ku fitimet "normale" korrespondojnë me situatën e ekuilibrit. Marrëveshja e heshtur mund të lindë kur firmat bashkëveprojnë në mënyrë të përsëritur.
- iii. Atëherë ato mund të jenë në gjendje të ruajnë çmime më të larta duke rënë dakord në heshtje se çdo devijim nga rruga e koluzionit do të shkaktonte një hakmarrje.

² https://ec.europa.eu/competition/mergers/studies_reports/the_economics_of_tacit_collusion_en.pdf

- iv. Hakmarrja i referohet reagimit të firmave ndaj një devijimi nga rruga kolusive. Për të qenë efektiv, hakmarrja duhet të nënkuptojë një humbje të konsiderueshme fitimi për firmën devijuese, krahasuar me fitimin që do të kishte fituar duke iu përmbajtur rrugës koluzive apo marrëveshjes së heshtur.
5. Meqënëse barra e proves bie mbi Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, Autoriteti e ka provuar se ka pasur Marrëveshje të bashkërenduar, rrjedhimisht marrëveshje të heshtur ndërmjet ndërmarrjeve në procedurë nëpër mjet analizave ekonomike dhe statistikore, si në vijim:

PËR PRODUKTI NAFTË

- a. Gjatë analizës dhe përpunimit të të dhënave vërejmë se nga muaji JANAR/18 - TETOR/18 mesatarja e fitimit bruto/l ka qenë 0.09 cent/l, ndërsa për muajin NENTOR/18 – DHJETOR/18 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.14 cent/l.
- b. Kur ngrisim paralelen e krahasueshmërisë për muajin SHKURT dhe DHJETOR, muaji SHKURT/18, çmimi blerës/l ishte 0.93 cent/l ndërsa fitimi bruto/l ishte 0.11 cent/l dhe çmimi shitës/l ishte 1.04 cent/l gjë që është reflektuese me çmimin e berzës botërore, ndërsa për muajin DHJETOR ku çmimi i berzës kishte rënie nga muaji paraprak dhe po ashtu çmimi importues/l ishte i njëjtë me atë të muajit SHKURT/18, 0.93cent/l, fitimi bruto/l për muajin DHJETOR ishte 0.22 cent/l dhe çmimi shitës/l ishte 1.14 cent/l gjë që ndërmarrja AL- PETROL ShPK nuk ka reflektuar me ulje të fitimit bruto/l karshi uljes së çmimit të berzës dhe çmimit importues.
- c. Forma e caktimit të çmimit apo marzha e fitimit duke aplikuar praktikë të bashkërenduar nga ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës, citoj: caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi.
- d. Mbi këtë bazë ligjore dhe faktet e konstatuara, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, vlerëson së ndërmarrja juaj ka caktuar çmimin shitës dhe marzhën e fitimit bruto/l për muajin NËNTOR dhe DHJETOR në mënyrë të bashkërenduar me kompanitë/ndërmarrjet tjera të cilat operojnë në tregun relevant, në shitje me pakicë, formë e bashkëpunimit e cila sanksionohet me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- e. Këtë konstatim Autoriteti ua paraqet me faktet si në vijim:




- f. Grafikoni më lartë ilustron çmimin blerës/l dhe fitimin bruto/l të të gjitha ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun relevant për gjatë vitit 2018. Në bazë të këtyre të dhënave të pasqyruara edhe në grafikon, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës vlerëson se:
- i. Gjatë muajve JANAR – TETOR ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun përkatës kanë pas një dallim të çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 9% fitimi bruto/l.
 - ii. Gjatë muajit NËNTOR krahasuar me mesataren e muajve JANAR – TETOR, çmimi blerës/l ka rritje për 2.0% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt JANAR – TETOR është rritur për 7% dhe mesatarja e fitimi bruto/l krahasuar me muajt JANAR – TETOR është rritur për 60% në raport me fitimin bruto/l për periudhën JANAR – TETOR.
 - iii. Gjatë muajit DHJETOR krahasuar me mesataren e muajve JANAR – TETOR, çmimi blerës/l ka rënie për 8% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt JANAR – TETOR ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt JANAR – TETOR është rritur për 124% në raport me periudhën e njëjtë.
6. Autoriteti konstaton se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant (shitje me pakice) nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto/l për muajin Nëntor e Dhjetor. Që do të thotë, se ndërmarrjet të cilat janë në procedurë hetimore, kanë pasur fitimin bruto/l përafërsisht 9% për muajt JANAR – TETOR, ndërsa për muajin Nëntor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto/l mesatarisht 60% dhe për muajin Dhjetor 124% në raport me periudhën Janar – Tetor.

PËR PRODUKTI BENZINË

- a. Gjatë analizës dhe përpunimit të të dhënave vërejmë se nga muaji JANAR/18 - TETOR/18 mesatarja e fitimit bruto/l ka qenë 0.14 cent/l, ndërsa për muajin NËNTOR/18 – DHJETOR/18 mesatarja fitimi bruto/l ishte 0.27 cent/l apo 12 cent më shumë.
- b. Kur e ngrisim paralelën e krahasueshmërisë për muajin (*shih grafikonin nr. 5*) muaji SHKURT e DHJETOR, muaji SHKURT/18 çmimi blerës/l ishte 0.91 cent/l ndërsa fitimi bruto/l ishte 0.15 cent/l gjë që është reflektuese me çmimin e berzës botërore, ndërsa për muajin DHJETOR ku çmimi i berzës kishte rënie dhe po ashtu çmimi importues/l ishte me i ultë se muajt paraprak 0.88cent/l, fitimi bruto/l për muajin DHJETOR ishte 0.29 cent/l, gjë që ndërmarrja AL – PETROL ShPK nuk ka reflektuar me ulje të fitimit bruto/l karshi uljes së çmimit të berzës dhe çmimit importues.
- c. Por forma e caktimit të çmimit apo të marzhës me praktikë të bashkërenduar nga ndërmarrjet cilat operojnë në tregun relevant, është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës, citoj: caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi.
- d. Mbi këtë bazë ligjore, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, vlerëson se kompania juaj ka caktuar çmimin shitës dhe marzhën e fitimit bruto për muajin NËNTOR dhe DHJETOR në mënyrë të bashkërenduar me kompanitë/ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant, formë e bashkëpunimit e cila sanksionohet me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

e. Këtë konstatim Autoriteti u'a paraqet me faktet si në vijim:



- f. Grafikoni më lartë, ilustron çmimin blerës/l dhe fitimin bruto/l të të gjitha ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun relevant të shitjeve me pakicë për gjatë vitit 2018. Në bazë të këtyre të dhënave të pasqyruara edhe në grafikun, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës vlerëson se:
- i. Gjatë muajve JANAR – TETOR ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun përkatës kanë pas një dallim të çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 12% fitimi bruto/l.
 - ii. Gjatë muajit NËNTOR krahasuar me mesataren e muajve JANAR – TETOR, çmimi blerës/l ka rënie për 5.0% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me periudhën e njejtë është rritur për 7.0% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt JANAR – TETOR është rritur për 108% në raport me fitimin bruto/l për periudhën Janar – Tetor.
 - iii. Gjatë muajit DHJETOR krahasuar me mesataren e muajve JANAR – TETOR, çmimi blerës/l ka rënie për 12% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt JANAR – TETOR ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt JANAR – TETOR është rritur për 135% në raport me periudhën e njejtë.
7. Autoriteti konstaton se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant (shitje me pakicë - benzinë) nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto/l për muajin Nëntor dhe Dhjetor. Që do të thotë, se ndërmarrjet të cilat janë në procedurë hetimore, kanë pasur fitimin bruto/l përafërsisht 12% për muajt JANAR – TETOR, ndërsa për muajin Nëntor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto/l mesatarisht 108% dhe për muajin Dhjetor 135% në raport me periudhën Janar – Tetor.
8. Se ç'farë u tha më lartë (a-f), Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës konstaton se kjo praktikë është e bashkërenduar e rrjedhimisht e kualifikon si *marrëveshje të heshtur* (Tacit Collusion), dhe që ka ç'rregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve NËNTOR e DHJETOR të vitit 2018, e që me këto veprime ndërmarrja AL - PETROL ka kryer shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, nenin 4 "Marrëveshje të ndaluar apo praktikë e bashkërenduar", paragrafi 1 nën paragrafi (1.1).

9. Andaj duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, neni 29 me pesë (5) vota unanime, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës vendosi si në dispozitivë të këtij Vendimi.

10. KALKULIMI I SANKSIONIT ADMINISTRATIV

1. Në mbështetje të nenit 56 par. 1 nen par. 1.1 si dhe neni 59 par.2 dhe 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ne mbështetje të Udhëzimit Administrative nr.01/2018 mbi kriteret për shqiptimin e masës së sanksioneve administrative neni 3, 4 dhe neni 8, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës kalkulimin e sanksionit administrative e ka bërë në këtë mënyrë:
2. Rasti i derivateve është për vitin 2018, ndërsa shkelja është konstatuar për muajt Nëntor dhe Dhjetor 2018. Tregu relevant janë derivatet e naftës, ndërsa zona gjeografike është territori i Kosovës.
3. Meqenëse periudha e shkelës së këtij ligji është më e shkurtër se 6 (gjashtë) muaj, Autoriteti e konsideron si gjysëm viti dhe ndëshkimi aplikohet në qarkullimin për periudhën Korrik – Dhjetor 2018, në përputhje me neni 4 par. 4 të Udhëzimit Administrative nr.01/2018.

ANDAJ

4. Qarkullimi për 6 muaj të vitit 2018 për ndërmarrjen AL PETROL shpk ishte: € [REDACTED]
 - a. Të hyrat bruto për 6 muaj: [REDACTED]
 - b. TVSH e përlogaritur (TVSH = Norma x 100 / Norma + 100) = 15.254%
 - c. TVSH: [REDACTED] x 15,254% = € [REDACTED]
 - d. Baza për aplikimin e Ndëshkimit (BN) = Të hyrat Bruto – TVSH ([REDACTED] - [REDACTED] = € [REDACTED])
 - e. Të hyrat Neto: € [REDACTED]
5. Baza e ndëshkimit është € [REDACTED]
6. AKK ka vlerësuar si një rrethanë lehtësuese faktin se palët kanë bashkëpunuar me Autoritetin gjatë procedurave dhe se asnjë palë nuk ishte ndëshkuar më parë për ndonjë formë të ç'rregullimit të konkurrencës.
7. Autoriteti ka konstatuar se shkelja ka ndodhur në muajt NENTOR dhe DHJETOR.
8. Autoriteti aplikon normën [REDACTED]% në Bazën e ndëshkimit € [REDACTED]
9. € [REDACTED] = **989,493.12 €**
10. Andaj duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, neni 29 me shumicë votash, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës vendosi si në dispozitivë të këtij Vendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente për çështje administrative.

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**

Valon PRESTRESHI
Kryetar

Ahmet KRASNIQI
Zv. Kryetar

Fatime S. HAZIRI
Komisioner

Muhamed KRASNIQI
Komisioner

Shaqir MORINA
Komisioner

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Arhiva
- Ndërmarrja AL - PETROL Shpk